



KOMUNA E PRISHTINËS
RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Kadastrit
Periudha raportuese	Qershor 2016
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Nora Kelmendi, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit

1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Drejtoria e Kadastrit - Zyra kadastrale komunale (ZKK) e Prishtinës, ka vazhduar të bëjë ofrimin e shërbimeve sa më efikase për qytetarë, duke ofruar informacione dhe të dhëna të azhurnuara për pronat e paluajtshme.

Gjatë muajit qershor në 6 zyrat pritëse, janë pranuar gjithsej **3,039** kërkesa, nga të cilat janë miratuar **2921** kërkesa, refuzuar **22** dhe kanë mbetur në procedurë edhe **125** kërkesa, të cilat janë realizuar përmes 2 sektorëve: Sektorit të kadastrit dhe Sektorit të gjeodezisë.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me planprogramin e Komunës për drejtorinë tuaj.

Aktivitetet e planifikuara të Drejtorisë së Kadastrit janë:

- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të pronësisë;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim dhe çregjistrim të hipotekës;
- Shqyrtimi i kërkesave për përmirësim të regjistrave kadastralë;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të banesave;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve;
- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë, parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënie të produkteve (koordinatave);
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njësisë banesore;
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe rirregullim kufiri;
- Shqyrtimi i kërkesave nga gjeodetët dhe kompanitë e licencuara;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

3. *AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.*

Në Drejtorinë e Kadastrit, gjatë muajit prill 2016, nëpërmes zyrave pritëse dhe 2 sektorëve, kadastrit dhe gjeodezisë, janë pranuar kërkesa të ndryshme, prej të cilave:

✓ **Në sektorin e kadastrit janë përpunuar kërkesat në vijim:**

- 328 kërkesa për regjistrim të pronësisë, prej të cilave janë miratuar 203, refuzuar 22 kërkesa për regjistrim të pronësisë, ndërsa janë njoftuar palët në procedurë me 103 konkluzione, duke u pezulluar procedura deri në plotësimin e lëndëve me dokumentacione përkatëse (*154 kërkesa të aprovuara nga muajt e kaluar*);
- 30 kërkesa për historik nga persona fizikë dhe institucione, prej të cilave janë miratuar 37, ndërsa (*7 kërkesa të miratuara nga muajt e kaluar*);
- 242 shkresa / kërkesa nga institucionet e ndryshme, që janë realizuar të gjitha;
- 195 kërkesa të tjera, si: përmirësime, ankesa, plotësim lëndë etj., të cilat janë realizuar në tërësi;
- 28 kërkesa për përmirësime, nga të cilat janë miratuar 23, ndërsa në procedurë kanë ngelur edhe 5 kërkesa;
- 7 kërkesa për barra tatimore, janë miratuar të gjitha;
- 1 kërkesa për lirim nga barra tatimore, e miratuar;
- 73 kërkesa për regjistrim të hipotekave, ku janë miratuar 69, ndërsa 4 kanë ngelur në procedurë, si dhe 52 kërkesa për çregjistrim, nga të cilat janë miratuar të gjitha dhe asnjë nuk ka ngelur në procedurë;
- 11 kërkesa – plotësim pagese për lëndë të Sektorit të kadastrit.

✓ **Në sektorin e gjeodezisë janë përpunuar kërkesat në vijim:**

- 984 kërkesa për certifikata të pronësisë dhe 835 kërkesa për kopje të planit, që në total janë pranuar dhe realizuar 1819 kërkesa;
- 8 kërkesa për ndarje të pronësisë, nga të cilat janë aprovuar 10 (3 nga muaji i kaluar), 1 kërkesë ka mbetur në procedurë për shqyrtim;
- 10 kërkesa për bashkim të parcelave, janë aprovuar gjithsej 10 kërkesa (1 nga muaji i kaluar) dhe 1 kërkesa ka mbetur në procedurë për shqyrtim;
- 85 kërkesa për dhënie e produkteve (koordinatave), të realizuar të gjitha;
- 86 kërkesa për identifikimin e njërive banesore, nga të cilat janë miratuar 94 (13 nga muaji i kaluar) dhe 5 kërkesa kanë ngelur në procedurë për shqyrtim;
- 10 kërkesa për përcaktim dhe rirregullim kufiri, nga të cilat janë miratuar 8 dhe 2 kërkesa kanë ngelur në procedurë për shqyrtim;
- 2 kërkesa për ndërrim kulture, të miratuara;
- 40 kërkesa nga gjeodetët dhe kompanitë e licencuara, nga të cilat janë miratuar 39 (1 nga muaji i kaluar) dhe 2 kërkesa kanë ngelur në procedurë për shqyrtim;
- 12 kërkesa zyrtare për përmirësime, nga palët dhe nga institucionet, si Ministria e Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Urbanizmit, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Agjencia Kosovare e Pronës (KPA) etj. dhe janë miratuar të gjitha.

Nga të dhënat e lartshënuara shihet se Drejtoria e Kadastrit ka implementuar gati **90** për qind (%) të planit të saj, duke i miratuar, refuzuar dhe pezulluar kërkesat e palëve në procedurë sipas shqyrtimeve ligjore që ka bërë lidhur me këto kërkesa.

E arritur e kësaj Drejtorie është që në afatin e përcaktuar ligjor prej 15 ditësh, ka arritur të nxjerrë vendime meritore për secilën prej kërkesave të parashtruara nga palët /subjektet juridike.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.

Aktivitetet në implementim e sipër nga Sektori i kadastrit, janë:

- Lëndët në shpallje publike, në afat prej **5** ditë pune, që kanë të bëjnë me regjistrimin e pronës së paluajtshme në operatin kadastral;
- Lëndët e dërguara në KPA, verifikim dhe pëlqime për regjistrim të banesave;
- Lëndët e dërguara për verifikim në gjykata, arkiv komunal ose ndërkomunal;

Aktivitetet në implementim e sipër nga Sektori i gjeodezisë, janë:

- Lëndët për ndarje, identifikim dhe bashkim të parcelave;
- Lëndët për identifikimin e njësisive banesorë;
- Lëndët për kërkesa zyrtare dhe kërkesa nga institucionet.

4.1.1. STATISTIKAT-Të listohen te gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxhetin e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të këtë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

Kërkesat e pranuar në Drejtorinë e Kadastrit, maj 2016	Numri total i kërkesave	Të miratuara	Të refuzuara	Në procedurë	Mjetet e grumbulluara €
Certifikata të pronësisë dhe kopje të planit	1,819	1,819	0	0	9,854
Kërkesa për RDPP (regjistrimi i të drejtës për pronë të paluajtshme)	328	203	22	103	11,005
Kërkesa zyrtare për historik, historik për persona fizikë dhe juridikë	30	37	0	0	180
Kërkesa nga institucionet e ndryshme dhe përgjigjet nga Gjykata dhe Institucione të tjera, Shërbimi i RDPP-së	242	242	0	0	
Kërkesa të tjera: përmirësime, ankesa, plotësim lënde etj.	195	195	0	0	40
Përmirësime në RDPP	28	23	0	5	560
Barra tatimore	7	7	0	0	210
Lirim nga barra tatimore	1	1	0	0	
Kërkesat për regjistrim të hipotekave	73	69	0	4	7,050
Kërkesat për çregjistrim të hipotekave dhe ndryshime	52	52	0	0	520
Plotësim pagese	11	11	0	0	192
Ndarjet - parcelimet copëtimet	8	10	0	1	395
Incizimi i ndërtesave, banesave					
Bashkimi i parcelave	10	10	0	1	468
Dhënia e produkteve - pikave kadastrale (koordinatave)	85	85	0	0	1,648
Identifikimi i parcelave dhe njësive banesore	86	94	0	5	1,568
Përcaktimi dhe rirregullimi i kufirit të parcelave	10	10	0	4	740
Ndërrim i kulturës	2	2	0	0	1,252
Plotësim pagese - gjeodezi					
Kërkesat me licencë	40	39	0	2	2,780
Kërkesa zyrtare nga institucionet - Shërbimi i gjeodezisë	12	12	0	0	
Totali	3,039	2,921	22	125	38,462

4.1.2 Buxhetin e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese.

Drejtorja e Kadastrit nuk shpenzon buxhet për të regjistruar të drejtat pronësore në regjistrat kadastral, përkundrazi, kjo drejtori realizon të hyra nga taksat e qytetarëve.

4.1.3 Takimet me palë

1. **Sektori i kadastrit**, gjegjësisht Zyra për regjistrimin e pronës së paluajtshme (RDPP), ka takime të rregullta me palë dy herë në javë (*ditët e marta dhe të enjte*) nga 2 orë në ditë me dy zyrtar ligjorë, ku ofrohen këshilla për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të palëve. Brenda këtyre 2 ditëve, 2 zyrtarët e Zyrës për RDPP takohen me rreth **300** qytetarë.
2. **Sektori i gjeodezisë**, ka takime të rregullta me palë. Gjatë këtij muaji ka pranuar **230** palë për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të tyre për ndarje, bashkim ose rregullim kufiri. Po ashtu ka takime me palë për identifikimin e banesave, si dhe takime të tjera me palë sipas kërkesave të tyre lidhur me çështjet pronësore.

5. Takimet me institucione të tjera

- **Sektori i kadastrit** - Takim me qytetarë për çështje të ndryshme kadastrale pronësore, për të cilat kemi zgjidhje ligjore ose i kemi udhëzuar palët që t'i drejtohen institucioneve tjera në vend. Takim me AKP-në për disa përgjigje të kthyera nga kjo agjenci.

5.1.1 Diskutime Publike/Takimet me qytetarë

Më **20 qershor 2016**, është mbajtur diskutimi i përgjithshëm publik me qytetarë.

6. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

– *Nuk kemi pasur.*

6.1.1 Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

- **Sektori i kadastrit:**
 - Lëndë të pranuar: **967**
 - Lëndë të miratuara: **840**
 - Lëndë të refuzuara: **22**
 - Lëndë në procedurë: **112**
- **Sektori i gjeodezisë:**
 - Lëndë të pranuar: **2,072**
 - Lëndë të miratuara: **2,081**
 - Lëndë të refuzuara:
 - Lëndë në procedurë: **13**

Vërejtje: 32 lëndë janë të kryera nga muajt e kaluar.

7. Takime të tjera

- *Nuk ka pasur.*

8. **SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, psh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.**

Spektori i kadastrit:

- Sfidues është komunikimi me institucione, mosdhënia e përgjigjeve nga ana e tyre në afat ligjor, të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve.

Spektori i gjeodezisë:

- Sfidues është komunikimi me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, mosdhënia e përgjigjeve nga ana e tyre lidhur me problemet që hasim çdo ditë me programin CadastralMap dhe SITK, të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve.
- Mungesa e shënimeve në pjesën grafike, gabimet të cilat janë krijuar me rastin e rikonstruktimit të disa zonave kadastrale nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

9. **REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë, etj.**

Spektori i kadastrit:

- Trajnime për punonjës sa i përket administratës dhe funksionimit të saj.

Spektori i gjeodezisë:

- Trajnime për punonjës sa i përket aplikimit të Kornizës së punës;
- Furnizim me printer me ngjyra;
- Furnizim me një skaner, i cili do të na ndihmonte në mbarëvajtjen e punës.

10. **AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES -Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues**

Spektori i kadastrit:

- Lëndët në shpallje publike, në afat prej 5 ditë punë;
- Lëndët në KPA për pëlqime për regjistrim të banesave;
- Lëndët për verifikim në gjykata, NPB, AKP, Arkiv komunal ose ndërkomunal.

Spektori i gjeodezisë:

- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë;
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënie e produkteve (koordinatave);
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njësive banesore;
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe rirregullim kufiri;
- Shqyrtimi i kërkesave për gjeodetët apo kompanitë e licensuara;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

11. **TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.**